

Erduan RASHICA



BROSHURA PËR AKSIDENTET RRUGORE

Prishtinë, 2015

UDHËTIMI I SIGURT BËHET VETËM ME RREGULLA



Rruga me të gjithë elementët e vet, trotuare, semafor, vijëzime, tabela të të gjitha llojeve, mjetet motorike, qofshin vetjake apo publike, biçikletat etj, na shërben që ne të kryejmë aktivitete sa më normale gjatë ditës.

Për mbarvajtjen më të mirë të këtij aktiviteti njerëzit janë në një mëndje e kanë rënë dakort për të patur rregulla e norma që pasqyrohen në kode e ligje ndaj të cilave qëndrimet vijnë e bëhen nga më të larmishmet.

Pikërisht tek të kuptuarit dhe sjelljet e shumllojshme gjenden shkaqet e aksidenteve me pasojë jo vetëm marrjen e plagëve por edhe me humbje jetë njerëzish.

Për drejtuesit e mjeteve të cilët kanë përgjegjësinë më të madhe në trafik që të bëjnë qarkullim të sigurt duhet të kenë në mëndje disa rregulla universale që të shoqërojnë gjatë gjithë udhëtimit si brenda zonave të banuara ashtu edhe në rrugët nacionale.

Kur këto rregulla bëhen pjesë e kulturës dhe e sjelljes së përditshme edhe rreziqet reduktohen por edhe aksidentet parandalohen në një masë të konsiderueshme.

Është një proverb gjermane që thotë;

Të ngasësh veturën nuk është kënaqësi e madhe, por është përgjegjësi shumë e madhe”.



Qëllimi jonë është të afrojmë disa rekomandime për të përmirësuar lëvizjet në trafik, duke synuar përfaqse sa më të mirë të sjelljeve me rregullat e përcaktuara.

KUJDES SHPEJTËSINË



Kufijtë e lejuar të shpejtësisë duhen respektuar me rigorozitet të lartë. Përshtateni shpejtësinë e lëvizjes së automjetit në varësi jo vetëm të rrugës, të kushteve klimaterike, por edhe të shikueshmërisë.

Drejtimi i mjetit me shpejtësi mbi normat e lejuara mbetet shkelje kryesore si burim për aksidentet automobilistike. Ato zënë afro 30 % të aksidenteve me pasoja të ndryshme. Këto aksidentet shkaktohen kryesisht nga drejtues mjeti me moshë të re, ku shfaqet kryesisht pakujdesia në formën e vetëbesimit të tepruar.

Sipas ekspertëve kur rritet shpejtësia nga 50 km/orë të lejuara në 80 km/orë është rreziku tetë herë më i lartë për tu

përfshirë në një aksident ku mund të vras një kalimtar në rrugë. E kundërta kur e ulim shpejtësinë vetëm 1 % numri i aksidenteve mund të zbres me 2-3%.

Ju kujtojmë se për tejkalim shpejtësie ju mund të gjobiteni, (neni 13.6 i kodit rrugore), 35€, “Penalizimi ” më i madh si rezultat i shpejtësisë është aksidentimi dhe lëndimi i jetës.



**ASNJEHERË MOS HARRO,
SHPEJTËSIA VRET**



Evitoni përdorimin e ALKOOLIT dhe substancave të tjera narkotike



Si alkoli ashtu edhe drogat të shkëpusin vëmendjen duke të "futur" në një realitet tjetër krejtësisht iluziv, euforik dhe të rremë, për këtë shkak nuk do jeni në gjëndje të kontrolloni mjetin tuaj dhe mund të aksidentoni vehten e të tjerët.

Të dhëna shkencore, kanë treguar se përdorimi i alkolit edhe në doza të vogla ndikon në reagimin e funksioneve psikike e fiziologjike në organizmin e njeriut.

Për shkak të alkolit rritet koha e reagimit; drejtuesi i mjetit reflekton përfytyrime të gabuara të pozicionit, vendndodhjes së mjeteve e përdoruesve të rrugës, kafshëve dhe të mjeteve të tjera që lëvizin. E thënë më ndryshe, kjo mungesë vëmendje dhe reagimi kohor me bazë përdorimin e alkolit mund të sjellë aksidente dhe ngjarje të rënda me pasoja fatale për jetën e njerëzve.

Edhe në këtë rast ju kujtojmë nenin 227.5 të kodit rrugor të RKS; Drejtimi i mjetit nën ndikimin e alkolit".

Nëse shoferi ka në organizëm ALKOOL mbi 0,5 gr/lit, 65-130 €.

Ndërsa sanksioni plotësues: pezullim i lejës së drejtimit 6 muaj ndërsa kur këto veprime përsëriten edhe me 1 vjet, kohë pezullimi.

Aksidentet për shkak të përdorimit të alkolit jo vetëm në botë por edhe tek ne kanë një përqindje që duhet konsideruar.

NGA SHISHJA MUND TË PËRFUNDOSH JASHTË RRUGË.



Në shumicën e rasteve prej gabimeve të drejtuesve të mjetit nuk janë dëmtuar vetëm këta të fundit por edhe të tjerë, bashkudhëtarë apo kalimtarë të rastit.

Prandaj që në lëvizjen e parë duhet të siguroheni.

MOS E NIS AUTOMJETIN APO MOTORÇIKLETËN PA RRIP SIGURIMI DHE KASKËN MBROJTËSE.



Në dukje veprime të vogla por që shmangin dëmtime që mund të jenë fatale për jetën tuaj.

Mosvendosja e rripit të sigurimit nga drejtuesit e mjeteve dhe personave të tjerë që bashkudhëtojnë është burim i lartë rreziku.

Megjithëse statistikak e deri tashme nuk na japin shifra të sakta se në çfarë shkalle është dëmtimi nga mos përdorimi i rripit të sigurisë mjafton të shohësh treguesit e gjositjes për drejtim pa masa mbrojtëse, të kuptosh se çfarë ndikim ka kjo



shkelje në fatalitetin e aksidenteve të ndodhura. Për një vit (vitin 2009) janë vendosur rrethë 15 850 gjopa ndaj atyre që janë gjetur pa masa mbrojtëse gjatë qarkullimit në rrugë.

SHPEJTËSIA VRET

Gjatë vitit të kaluar ,gati 8,000 persona janë lënduar në aksidentet e ndërlihdura me shpejtësin, nga që 175 nga ta kanë vdekur.

Është më mire që ta humbësh një minute në jetë se sa ta humbësh jetën për një minute.

KUJDES!!!

Duke pare gjendjen në rrugët e Republikës së Kosovës,ky broshur ndoshta mund të "frenoi" dhe sensibilizoi sadopak gjendjen alarmante të rrugëve në Kosovë.

VËPRIMI I NXITUAR MUND T'JU KUSHTOJË JETËN.



Nga parakalimi i gabuar dhe mosrespektimi i lëvizjes së mjetit në korsinë e duhur janë shkaktuar mbi 30% e aksidenteve në rrugët tona.

Edhe në këto raste shkalla e fatalitetit, pra numri i aksidenteve me pasojë vdekjen është i lartë. Këto ndodhin nga drejtues të rinj, impulsiv që ngasin makina me fuqi të lartë motorike, si dhe mjete që kanë timon në krah të kundërt.

Për të evituar qoftë edhe përplasje të lehta në rrugët urëbane dhe ato më të rënda në rrugët interurbane respektoni distancat e sigurisë.

Në Kodin Rrugor janë të mirëpërcaktuara këto distanca

sipas rrugës shpejtësisë së lëvizjes, të cilat duhen njohur e respektuar.

**QËNDRONI NË DISTANCËN E DUHUR,
KËSHTU JENI TË SIGURTË**



Perdorimi ne masë i telefonave celularë e ka shtuar riskun e aksidenteve, ndaj kërkohet të jemi më të kujdesshëm ndaj këtij elementi të ri të panjohur më parë.

Në disa vende të Europës janë bërë përshtatjet ligjore duke i paraprirë mjaft problemeve me të cilat po përballen të gjithë.

Sanksionet janë vendosur (edhe pse jo te forta) pasi përdorimi i celularit gjatë udhëtimit nga drejtuesit e mjeteve, ul vëmëndjen, kufizon përdorimin e të gjitha mundësive në situata të caktuara, bëhet shkak për aksidente që mund të jenë edhe fatale si për ata që “krijojnë” këtë situatë ashtu edhe për të tjerët që janë në rrugë.

Kufizoni përdorimin e telefonave celularë gjate udhëtimit, ose në rast të kundërt përdorni kufjet që të jeni të lirë në drejtimin e mjetit.

PËRDORIMI I APARATEVE GJATË DREJTIMIT TË AUTOMJETEVE

Në udhëtime të gjata bëni kontrollin teknik të mjetit, sigurohuni që të keni të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor për qarkullimin.



Një mjet në gjëndje të mirë teknike dhe dokumentacion të kompletuar sipas ligjeve në fuqi për qarkullimin rrugor e rrit sigurinë tuaj në udhëtim dhe e bën atë më të këndshëm.

Kontrolli teknik i veturës



Në përfundim shtrojmë pyetjen:

**VETËM DREJTUESIT E MJETEVE MOTORIKE JANË PËRGJEGJËS PËR ZBATIMIN
E KODIT RRUGOR TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS ?**

Natyrisht në raste konkrete është e lehtë të përcaktohen shkaqet dhe shkaktarët por në tërësinë e vet siguria rrugore është mjaft komplekse dhe për t'a arritur duhen shumë operatorë, që marrin mbi vehte përgjegjësi dhe objektiva të mirëpërcaktuara..

Rruga si një mjet komunikimi i shoqërisë ka kodet dhe rregullat e saj të cilat duhet të njihen dhe të zbatohen me korrektesë nga përdoruesit e rrugës.

Në trafik nuk ka vetëm automjete dhe drejtues të tyre, por edhe këmbësorë, biçikleta, motorcikleta, asistencë e policisë rrugore etj.



Përdoruesit e rrugës duhet të njohin pasojat në rast se nuk zbatojnë rregullat e qarkullimit rrugor. Njohja dhe zbatimi i Kodit Rrugor është pjesë e kulturës dhe pasqyrë e sjelljeve që ju bëni çdo ditë në rrugë, ajo trajtohet si komponent i edukatës qytetare që përftohet nga femijëria, në programet shkollore e më tej.

Në funksion të këtij qëllimi, duke patur parasysh ç'ka shtruan më sipër, krijimin e koncepteve të reja për sigurinë rrugore, që çojnë në mbrojtjen e jetës së qytetarëve, mendojmë të afrojmë këtë material për të inkuadruar më shumë kapacitete të kualifikuara dhe të besueshme.

Të njëjtat rregulla vlejnë edhe për përdoruesit e rrugës, këmbësorë, apo biçiklistë.

Siguria rrugore nuk mund të arrihet pa kontributin dhe sjelljen normale edhe të përdoruesve të tjerë në trafik, jo vetëm të atyre që drejtojnë mjetet motorike.

Që përdoruesit e rrugës me këmbë të ecin të qetë, është e domosdoshme të kenë njohuri mbi rregullat të cilat kondicionohen nga sinjalistika në qytet dhe jashtë tij.

Por jo gjithkush e di se në rast se rruga nuk ka trotuare, nevojitet të qarkullojmë në krahun e majtë, pasi vetëm kështu ju mund të shikoni mjetet që ju vijnë përballë, dhe të evitoni aksidentet e mundshme.

Kujdes duhet treguar kur kaloni rrugën me fëmijët për dore, mbajini ato gjithnjë në krahun e kundërt nga vijnë mjetet. Mos harroni se fëmijët për dore duhet të mbahen mirë dhe me kujdes dhe në krahun tuaj të majtë.

Në kushtet e ndriçimit të kufizuar (natën apo me kohë të keqe) drejtuesit e mjeteve e kanë vështirë t'ju shikojnë. Në këto kushte duhet të tregoheni shumë të kujdesshëm, si në veshjen e rrobave (që ato të jenë me ngjyra të çelta) ashtu edhe për të mbajtur në dorë sende që ju identifikojnë (elektrik dore apo dhe diçka tjetër fosforishente).

Për të kaluar rrugën, në kryqëzim, në semafor apo edhe kur qarkulloni në rrugë të drejtë, sigurohuni që drejtuesi i mjetit po ju shikon.

Në udhëkryqe sidomos fëmijët e kanë të vështirë të orientohen si duhet në trafikun rrugor sepse automjetet ose biçikletat mund të vijnë nga të gjitha anët. Fëmijëve u duhetnjë kohë më e gjatë për të parë nga të katër drejtimet dhe ndërkohë që ata janë duke bërë këtë, përdorues të tjerë të rrugës kanë ose janë duke ardhur.

Përpara se të kalohet rruga duhet që gjithmonë të shohim në të dyja drejtimet, sepse edhe mjetet vijnë nga të dyja drejtimet. Në fillim shikoni nga ana e majtë pasi kjo është ana në të cilën mjetet dhe rreziku prej tyre janë më pranë jush.

Të sigurohemi derisa nuk ka mjete që kalojnë në të dyja drejtimet dhe vetëm kur të sigurohemi për këtë, të kalojmë rrugën.

Gjatë kalimit të rrugës, nuk duhet të vrapojmë, por të ecim shpejt duke parë në të dyja drejtimet.

Nëse dëshirojmë të përshkojmë një largësi më të madhe në rrugë, kjo do t'u kërkojë më shumë kohë. Kjo do të thotë se mundësitë për të ndeshur me automjete janë më të mëdha. Kjo është arsyeja pse ne nuk duhet ta përshkojmë rrugën duke ecur diagonal me të, por të zgjedhim rrugën më të shkurtër dhe me hap të shpejtë.

Përdoruesit e rrugës këmbësorë duhet të mësojnë se nëse ekzistojnë sinjalizime për trafikun, (tabela, vija të bardha, semaforë, mbikalime etj) ato duhet të përdoren. Kjo do të thotë për shembull se nëse është ndezur sinjali jeshil i semaforit që i lejon kalimtarët të kalojnë rrugën, këta kanë përparësi ndaj çdo mjeti tjetër. Megjithatë përdoruesit e mjeteve duhet të mbajnë parasysh që t'u japin përparësi kalimtarëve duke respektuar rregullat e mëposhtme:



Gjithnjë NDALO përpara një kthese kur sinjali është i kuq.

- PRIT gjithnjë për dritën e gjelbërt
- SHIKO mirë në të dy anet e rrugës përpara se të kalosh
- Kur të kalosh rrugën zgjidh rrugën më të shkurtër, duke parë mirë në të dyja drejtimet.
- Koha e qëndrimit në rrugë duhet të jetë sa më e shkurtër.

Mos harro!

Ndalo të gjesh vend të sigurt para se të vendosësh të kalosh rrugën.



Të sigurta janë vetëm këto vende;

Mbikalimet dhe nënkalimet, aty ku ka sinjalistikë, semafor apo vija të bardha (zebra).

Momenti kur ndodhet pranë polici rrugor, kur ka më të rritur, dhe njerëz të grumbulluar në pritje për të kaluar rrugën.



Në ato raste kur këto kushte mungojnë mundohu të zgjedhësh një pozicion që të kenë edhe ju edhe drejtuesi i mjetit fushëpamje të gjërë.

Sjellja e përshtatshme në rrugë rrit dhe garanton një qarkullim të sigurtë si për drejtuesit e mjeteve ashtu edhe përdoruesit e tjerë të saj.

**Hulumtuar nga interneti si dhe duke u bazuar në ligjin mbi
sigurin e komunikacionit rrugor të Republikës së Kosovës**

**Hartuesi i kësaj broshure është studjuesë i
Komunikacionit Rrugor.**

